



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Planuar / Dorezuar Puniljen/Prodato Received/Delivery	24.10.2022	2	viti god year
Organ /Njesia Organ./Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHK	6400	2022	119



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.791/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani -kryetar, Ardita Haxhnikaj – Demi dhe Jeton Koca, anëtarë, si dhe Rushit Kajtazi -Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.791/2022 të datës 12.09.2022, të parashtruar nga ankuesja, me adresë nga kundër organit të Punësimit Komuna e Podujevës, në çështjen juridike “Kontestim Konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 24.10.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. REFUZOHET si e pa bazuar ankesa A.nr.791/2022 e datës 12.09.2022 e parashtruar nga ankuesja
- II. MBETET në fuqi Vendimi me Nr. 13-111/01-0075247/22 i datës 05.09.2022 i Komisionit të Vlerësimit të Lëvizjes Brenda Kategorisë në Komunën e Podujevës.

Arsyetim

Komuna e Podujevës më datë 18.07.2022 ka njoftuar se ka shpallur konkursin me Nr. Reference: RN000009465, për lëvizje brenda kategorisë për pozitën Zyrtar për Shërbim me Qytetar, ku afati për aplikim ka qenë nga data 02.08.2022 deri më datë 09.08.2022. Në këtë konkurs ka aplikuar edhe ankuesja e cila i është nënshtruar intervistën me gojë, mirëpo që nuk ka fituar pikët e nevojshëm për emërim.

Komuna e Podujevës në bazë të Njoftimit me Nr. 13-111/01-0073337/22 të datës 26.08.2022 ka bërë përfundimin e procedurës për këtë pozitë pa fitues për shkak që asnjë prej kandidatëve nuk ka marr pikët e nevojshme.

Ankuesja ka parashtruar ankesë në Komisionin për Vlerësimin e Lëvizjes Brenda kategorisë, ndërsa ky i fundit përmes Vendimit me Nr. 13-111/01-0075247/22 të datës 05.09.2022, ka refuzuar ankesën e ankueses, duke e lënë në fuqi njoftimin e datës 26.08.2022.

Ankuesja, me datë 12.09.2022, ka parashtruar ankesë me numër protokollit 5307/2022, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 14.09.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Komuna e Podujevës. Ndërsa Këshilli me datë 20.09.2022, ka pranua nga Komuna e Podujevës, përgjigjen në kërkesë me numër protokollit: 5697/2022, se bashku me shkresat e bashkangjitura.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova:** Ankesën e ankueses me nr. protokollit 5307/2022, të datës 12.09.2022, e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kopjen e konkursit të datës 18.07.2022; Njoftim për përfundimin e procedurës rekrutim me nr.13-111/01-0073337/22 i datës 26.08.2022; Njoftim nga Njësia e Burimeve Njerëzore, me nr.13-232/2022 i datës 10.08.2022; Vendim i Komisionit të Vlerësimit Brenda Kategorisë në nr.13-111/01-0075/22 i datës 05.09.2022; dokument identifikimi i [ ] i datës 15.02.2022; Certifikatë e vendbanimit e datës 07.09.2022; Certifikatë e Martesës e datës 15.01.2021; Akt emërimit me nr.2248 i datës 21.07.2017; Vërtetim i datës 12.04.2022; Ekstrakt nga Regjistri Qendror i Gjendjes Civile i datës 04.02.2022; Diplomë e Studimeve Themelore Universitare e datës 02.10.2014; Certifikatë për trajnimin për zyrtarët e gjendjes Civile i datës 05-08.04.2019; Formular Për Vlerësimin e Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil e datës 09.02.2022; Certifikatë nga Agjencia Kadastrale e Kosovës e datës 07.02.2022; CV, e [ ] Lista e Aplikanteve; Vlerësimi individual i kandidateve për vendin e punës; Aplikacioni i [ ] me shkresat e bashkangjitura; diplomë e datës 02.10.2014, me numër 1205/14; Certifikatë e datës 08-09, e muajit nëntor të vitit 2018; Kontrate e Punës për Mësimdhënie e datës 20.09.2007; Vërtetim i datës 12.04.2012; C, V, e [ ] Vërtetim i datës 13.06.2022; Aplikacioni i [ ] i datës 03.08.2022; Diplomë e datës 06.12.2013; Libreza e Punës datës 02.07.1985; Vërtetim për Punësim i datës 20.01.2003; Kontrata e punës e datës 05.01.2004; Kontrata e Punës e datës 01.08.2003; Kontrata e punës e datës 05.01.2004; Akt Emërimi i datës 23.03.2012; Formular për Vlerësimin e Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil i datës 31.01.2022; Formularë për Vlerësimin e Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil i datës 27.01.2021; Vërtetim i datës 02.08.2022; Njoftimi i datës 26.08.2022; për Themelimin e Komisionit për lëvrije brenda kategorisë;

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas shqyrtimit të të gjitha shkresave të lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankueses është e pabazuar, sepse:



Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, në bazë të administrimit të provave të lëndës, konstaton se Njësia e Burimeve Njerëzore e Komunës së Podujevës, me rastin e vlerësimit të aplikacionit dhe përfshirjes së saj në listën e shkurtër respektivisht verifikimin paraprak ka vepruar në pajtim me Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 Për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, respektivisht neni 45 të kësaj rregulloreje, ndërsa në intervistë me gojë është ftuar ankuesja si kandidatë që ka kaluar verifikimin paraprak në kuptim të paragrafit 3 të nenit 45 të Rregullores (QRK) NR. 16/2020 Për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Në intervistë me gojë ankuesja është vlerësuar me gjithsejtë 58.6 pikë, ndërsa tek procedura e lëvizjes brenda kategorisë kandidati për të qenë fituar duhet të marrë të paktën gjashtëdhjetë (60) pikë, siç parashihet me nenin 49 paragrafi 2 të Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 Për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i cili përcakton se: *“Kandidati që është vlerësuar me më shumë pikë dhe që ka marrë të paktën gjashtëdhjetë (60) pikë është kandidati fitues dhe ka të drejtën të emërohet në pozitën e lirë për të cilën është zhvilluar konkurimi. Kandidati fitues në rastin e kandidatëve me pikë të barabarta përcaktohet, nga NJBNJ sipas nenit 27 të kësaj Rregulloreje, dispozitat e të cilit zbatohen përshtatshëm”,* ndërsa në rastin konkret asnjë nga kandidatët nuk ka arritur të marrë numrin e pikëve të nevojshme, ndërsa nëse asnjë nga kandidatët nuk është vlerësuar me gjashtëdhjetë 60 e më shumë pikë, procedura e lëvizjes brenda kategorisë përfundon pa kandidat fitues, siç parashihet me nenin 49 paragrafi 3 të Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 Për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton e meqenëse nuk janë plotësuar kushtet ligjore për emërim, atëherë Njësia e Burimeve Njerëzore e Komunës së Podujevës me rastin e nxjerrjes së Njoftimit me Nr. 13-111/01-0073337/22 të datës 26.08.2022 për përfundimin e procedurës për këtë pozitë pa fitues, ka vepruar në pajtim me nenin 49 paragrafi 3 të Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 Për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Po ashtu Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se Komisioni për Vlerësimin e Lëvizjes Brenda Kategorisë në Komunën e Podujevës me rastin e nxjerrjes së Vendimit me Nr. 13-111/01-0075247/22 të datës 05.09.2022, ka vepruar në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr. 06/1 - 114 për Zyrarët Publikë, Rregullores (QRK) NR. 16/2020 Për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, dhe Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, sepse ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe juridike, kështu që pretendimet e ankueses janë të pa bazuara.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se meqë procedura e lëvizjes brenda kategorisë ka dështuar për shkak që nuk ka pasur kandidatë fitues, atëherë aplikohen dispozitat e nenit 34 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrarët Publikë.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.791/2022

Rushit KAJTAZI

Procesmbajtës



Eshref SHABANI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses
- Kryetarit të Komunës së Podujevës;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Podujevës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.